



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	29.07.2026	14.08.2026	2026/0535

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.07.2026, OE “BAJRAM HA.GASHI B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0535, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Mergant”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rindertimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindertimi dhe renovimi i strehes ne sallën e sporteve te shkolles Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindertimi dhe renovimi i shkolles SHMFU Pjeter Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit te salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejës” me nr. të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontrates: : **42.653.09** €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe

Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

Neni 130 - Ndikimi i paligjeshëm.

Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 97 - Shkeljet e rënda të LPP-se

e nderuar,

Me 10.07.2026 Komuna Pejë- Zyra e Prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin

Ak-së, formularin B58 për lotin 1 ku ka rekomanduar OE të përgjegjshme.

e

Me datën 15.07.2026, kundër këtij vendimi kemi parashtruar kërkesë për ri shqyrtim dhe

kemi prezantuar prova dhe fakte për veprime kundërligjore, përderisa Komuna Pejë, me

datën 16.07.2026, nxjerre vendim dhe refuzon kërkesën tonë si të pa baze, përderisa

pretendimet ankimore fare nuk i trajton, prandaj bazuar në nenin 109, të LPP-se paraqesim

faktet tona si më poshtë:

Pretendimi ankimore 1.

Me vendimin e datës 16.07.2026 Komuna Pejë, ka refuzuar kërkesën tonë për Rishqyrtim pa

e analizuar dhe pa e arsyetuar asnjë nga pretendimet tona ankimore të përfshira në kërkesë

për rishqyrtim, duke u mjaftuar me fjalinë përgjithësuese se - "pretendimet janë të

njëanshme"!

Mosanaliza e provave dhe jo përgjegjësia zyrtare nga AK, përkatesisht zyra e prokurimit,

përbën shkelje thelbësore procedurale që cenon të drejtën kushtetuese, mbrojtjes dhe

barazisë administrative.

Potencimi i AK-së se ankuesi mban renditjen e katërta në lotin 1, nuk e largon atë nga e drejta e kontestimit të ofertave tjera të papërgjegjshme që renditen para, dhe mos trajtimi i 10 pretendimeve tona ankimore të paraqitura në kërkesë për ri shqyrtime shkele në tërësi nënin 108/A të LPP-se, marrë parasysh faktet se në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në aneksin 7 të FDT-së

Pretendimi ankimore 2.

Operatori ekonomik i propozuar për dhënie kontrate në lotin 2 Mondi Shpk, ku edhe në lotin 1 ka ofertuar dhe ka qenë i dyti me çmimin më të lirë, dhe si kriter në FDT ka qenë që në piken 2.3

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: 1

Vrejtje :O.E do të shpërblehen vetëm me një LOT.

O.E do të shpërblehen vetëm me një LOT. Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se 1 LOT atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për LOTIN që i cili është më i favorshëm për Autoritetin Kontraktues.Po ashtu në rast se në OE oferton në më shumë se një LOT vlen përmbushja e kriterit të LOTIT më të madhe Në FDT 8.1 & 8.2 është kërkuar që Operatori Ekonomik Lotin 1 duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme tatimore se qarkullimi vjetor gjatë tri viteve të fundit financiare ka qenë jo më pak se 80000.00 Euro. Si dëshmi kërkohen " Deklarata e dorëzuar në Administratën Tatimore të Kosovës"

Në ofeten e OE " Mondi " Shpk mungon Qarkullimi nga Atk-ja dhe ta refuzoni si të papërgjegjshëm.

Pretendimi ankimore 3.

Në dosjen e tenderit (FDT) Pika 9.1 & 9.2 për lotin 1 kërkohet që inxhinieri apo Menaxheri 4/8

i Projektit të ketë diplomë, Cv-në, kontratën si dhe vendimin për menaxher të vëlosur dhe nënshkruar nga Kompania".

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "BAJRAM HA.GASHI B.I.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

OE "Mondi Shpk " nuk e ka dorzuar vendimin mbi menaxherin e projektit siq është kërkuar në dosjen e tenderit, mos plotësimi i kriterit sipas FDT duhet ta refuzoj oferten si të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 4.

Në dosjen e tenderit (FDT) Pika 9.1 & 9.2 Për (LOT-1) &(LOT-2)

Kërkesa 2 Menaxheri i projektit - të jetë Master shkencë (Msc) i ndërtimtaris (Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtaris) Drejtimi Konstruktive me së paku 5 vite provë pune pas diplomimit

Për (LOT-1) &(LOT-2) Dëshmia 2 Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet të ketë Diplomen-kopje, me kontrat apo parakontrat në emër të projektit-, vendim për projekt menaxheri i vëlosur dhe nënshkruar nga Kompania si dhe CV-në e nënshkruar nga vet inxhinieri të dokumentuar me trust.

OE "Mondi Shpk "nuk e ka dorzuar " Inxhinieri i dokumentuar me trust "siq është kërkuar në dosjen e tenderit, mos plotësimi i kriterit sipas FDT duhet ta refuzoj oferten si të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 5.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit pika 9.1 & 9.2, përcakton që operatori duhet të dëshmojë kontratë të përfunduara për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë minimale prej (loti 1- 60000.00 euro dhe (loti 2 -75,000.00 euro) në 3 vitet e shkuara dhe duke qenë se Loti 1 dhe Lotin 2

OE Mondi Shpk sipas listës së paraqitur ka kryer punën e infrastruktures nëntokësore (Trotuare, ndriqim, kanale ujë), që nuk janë punë të ngjashme siq kërkohet dysheme - parket, mosplotësimi i kriterit sipas FDT duhet të refuzohet oferta e operatorit si papërgjegjshme për të dy lotet.

Pretendimi ankimore 6.

e

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “BAJRAM HA.GASHI B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sportive të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Juve si AK - Komuna Peje hapjen e ofertave për këtë projekt e keni realizuar më datën 19.05.2026, ndërsa vendimi i juaj si Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë dhe eliminim është marrë dhe publikuar më datë 10.07.2026, ku kjo nënkupton se Komisioni i Vlerësimit ka konsumuar saktësisht 52 ditë kalendarike për të nxjerrë vendimin përfundimtar.

Ky aktivitet i prokurimit, specifikisht Lot 1 dhe 2, nuk ka pasur asnjë element të kompleksitetit teknik apo financiar dhe se paramasa konsiston vetëm në dy pozicione standarde ndërtimore: furnizim/ndërtim muresh dhe lyerje dispersive/yndyrore të mureve e tavanit dhe nuk ka pasur asnjë arsye objektive apo volum dokumentesh që do të arsyetonte një tejzgjatje prej 52 ditësh apo 22 ditë përtej afatit maksimal të lejuar ku keni mbajtur të bllokuar procedurën në mënyrë të paligjshme, duke shkelur parimin e efikasitetit dhe

5/8

ekonomicitetit të prokurimit publik.

Pretendimi ankimor 7.

Në Dosjen e Tenderit (FDT), piken 9.1 & 9.2 shprehimisht kërkohej që Operatori duhet të dëshmojë kontrata të përfunduara me sukses për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë prej 60,000.00 euro në 3 vitet e shkuara dhe se natyra e ngjashme për Lotin 1 specifikon rreptësisht punimet e parketit si heqje, montim, gërryerje në 5 faza, llakim me standarde FIBA dhe se në ofertën e OE të propozuar në lotin 1 OE Migrant Ing, e vetmja kontratë që specifikon punë parketi është ajo e Komunes së Lipjanit me vlerë vetëm 5,633.33 euro ndërsa kontratat tjera të deklaruara kanë të bëjnë me renovime bodrumesh, gëlqerosje institucionesh, ose renovime zyrash të pensioneve, të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme me parket siç është objekti i kësaj kontrate perkatese.

OE Mergant Ing Shpk Kompania ka vetëm një kontratë me vlerë 5,633.33 €, përvojë specifike në parket dhe shuma e kontratave të tjera për gëlqerosje dhe izolime nuk mund të përlogaritet si përvojë e ngjashme për dyshe me sportive FIBA, pra operatori dështon drastikisht të mbërrijë pragun prej 60,000.00 euro të kërkuar për Lotin 1.

Pretendimi ankimore 8.

Në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe FDT, përkatësisht në dëshminë nr. 4, është kërkuar që pajisjet motorike duhet të dëshmohen me kopje të librezave të qarkullimit ku vërtetohet se janë valide dhe të regjistruara rregullisht.

Në ofertën e OE të propozuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit "Caddy" furgon me targa 01-499-NO, të ngarkuar nga kjo kompani, vërehen ndërhyrje të qarta manuale tek data e vlefshmërisë dhe të nënshkrimet zyrtare të vulës dhe se nëni 6.3 pika k e DT-së dhe nëni 65 i LPP-së ndalojnë rreptësisht dorëzimin e dokumenteve me përmbajtje të ndryshuar, të rreme apo mashtruese dhe se çdo ndërhyrje manuale mbi një dokument zyrtar shtetëror apo libeze të qarkullimit rrugorë e bën atë të pavlefshëm dhe sjelle diskualifikimin e menjëhershëm të operatorit, madje ligjërisht juve si AK do duhej të ndermerrnit veprime ligjore në kuptim të nenit 99.2 të LPP-së dhe jo të rekomandonit për dhënie të kontratës ofertën e tillë.

OE " Mergant Ing Shpk "nuk e ka dorëzuar dokumentin siq është kërkuar në dosjen e tenderit, mos plotësimi i kriterit sipas FDT duhet të refuzoj ofertën si të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 9.

Në dosje të tenderit përkatësisht oken 9.1 & 9.2 të FDT-së, kërkohet angazhimi i minimum 8 punëtorëve teknikë të përshtatshëm për realizimin e projektit dhe se OE në listën e të punësuarve dhe kontratat e punës të dorëzuara, ka ofruar profilet: Moler-Fasader, teknik i ujësjellësit, teknik i ujësjellësit dhe kanalizimit, ndihmës moler-fasader dhe teknik i elektroteknikës. Pra asnjë punëtor i vetëm i tyre nuk është i certifikuar apo i profilit parketar. Objekti i kontratës dhe punët e kërkuara në Lotin 1, konsistojnë ekskluzivisht në vendosjen dhe strugimin profesional të parketit të sallës së edukatës fizike dhe se ofrimi i stafi të përbërë

6/8

nga molerë, elektrikistë dhe hidraulikë nuk garanton realizimin e punëve specifike sipas standardeve FIBA dhe bie ndesh me nenin 59 të LPP-së.

OE " Mergant Ing Shpk "nuk e ka dorëzuar dokumentin siq është kërkuar në dosjen

tenderit, mos plotësimi i kriterit sipas FDT duhet ta refuzoj oferten si të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 10.

e

Oferta e OE Hajrush Shoshi BI e kualifikuar si e përgjegjshme në lotin 1 është në tërësi e pa përgjegjshme pasi që në FDT, ër Lot 1, juve si AK keni kekruar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë prej 60,000.00 euro në 3 vitet e shkuara ku si dëshmi është kërkuar plotësimi i aneksit 6, të cilit duhet ti bashkëngjiten referencat dhe certifikatat e kryerjes së punëve ku saktësohet vlera, data dhe vendndodhja.

Në ofertën e OE Hajrush Shoshi B.I., është prezantuar një kontratë bashkëpunimi me kompaninë "CTA" SH.P.K për projektin "Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrell - Vazhdim".

Mirëpo, ky angazhim ka qenë në cilësinë e nënkontraktorit dhe për të vërtetuar vlerën faktike të punëve të kryera nga vetë ai, operatori nuk ka bashkëngjitur asnjë situacion teknik të nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe asnjë faturë financiare, por ka dorëzuar vetëm një pasqyrë të qarkullimit bankar të NLB Bankës.

Pra pasqyra e thjeshtë e qarkullimit bankar tregon vetëm transaksione monetare apo hyrje parash, por nuk përbën dëshmi ligjore ndërtimore që vërteton se cilat pozicione të punës janë ekzekutuar, në çfarë cilësie dhe në çfarë vlere, rrjedhimisht pa situacione zyrtare dhe fatura që ndërlidhen me librat e ndërtimit, është e pamundur të vërtetohet nëse ky OE ka përmbushur pragun minimal prej 60,000.00 euro për punë të ngjashme të parketit për lotin 1, prandaj kjo referencë është e paverifikueshme dhe oferta duhet të shpallet e papërgjegjshme automatikisht.

OE "Hajrush Shoshi B.I. " nuk e ka plotësuar kriterin siq është kërkuar në dosjen e tenderit, mos plotësimi i kriterit sipas FDT duhet ta refuzoj oferten si të papërgjegjshme.

Si përfundim, të gjitha 10 pretendimet ankimore të paraqitura, asnjë pretendim nuk është trajtuar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të ofertave bazuar në nenin 59.1 të LPPse, mbajnë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “BAJRAM HA.GASHI B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

përgjegjësi individuale ligjore për ekzaminimin objektiv dhe jo konform

kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit, ku favorizimi i OE të propozuar për dhënie të kontratës në lotin 1, është e sanksionuar edhe me nenin 97, të RrPP-se, marrë parasysh edhe faktin se zyrtari përgjegjës i Prokurimit ka nxjerrë vendim shablon, të përgjithësuar

7/8

dhe të paarsyetuar dhe pa e trajtuar asnjë prej 10 pretendimeve ankimore.

Prandaj për të garantuar pa anësinë e këtij procesi të prokurimit kërkojmë që OSHP, në kuptim të nenit 113 të LPP-së të caktoj ekspert shqyrtues të pavarur dhe të paaneshëm i cili do të trajtoj të gjitha pretendimet tona ankimore për lotin 2 në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerre këtë;

VENDIM

I. Të aprovohet në tërësi e bazuar ankesa e OE "Bajram Ha. Gashi B.I.", si e bazuar;

II. Të anulohet, njoftimi i datës 10.07.2026, formulari B58, propozimi për dhënien e kontratës dhe loti 1, të kthehet në Ri-vlerësim.

III. Të lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës.

Të gjitha këto prova tregojnë për tentative abuzimi me parane publike, keqperdorimin dhe mashtrimin në prokurim Publik dhe detyrë zyrtare, prandaj kërkojmë përgjegjësi ligjore dhe profesionale me rastin e trajtimit të kësaj anese..

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit - FDT

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Pergjigja nga AK 1

Pas analizimit të të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konstaton se asnjëri nga pretendimet nuk qëndron dhe nuk mbështetet në gjendjen faktike të dokumentacionit të tenderit.

Procedura e vlerësimit është zhvilluar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Operatori Ekonomik **Bajram H. Gashi B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit:

- LOT 1 – Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në IAAP "Rifat Gjota";
- LOT 2 – Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në Shkollën Fillore "Lidhja e Pejës",

pas analizimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, raportit të vlerësimit, procesverbalit të komisionit të vlerësimit dhe pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, konstaton si në vijim:

Pas shqyrtimit të plotë të pretendimeve të Operatorit Ekonomik, Komisioni vlerëson se ato janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në prova apo argumente që do të dëshmonin se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, apo me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se procesi i vlerësimit është zhvilluar në mënyrë të drejtë, transparente dhe në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, duke respektuar parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, konkurrencën e ndershme, transparencën dhe përdorimin ekonomik të fondeve publike.

Sa i përket LOT-it 1 – Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në IAAP "Rifat Gjota", oferta e paraqitur nga OE **Bajram H. Gashi B.I.** nuk ka qenë oferta me çmimin më të lire sipas FDT-se, por është renditur si **oferta e katërt (4) me çmimin më të lartë** në këtë lot. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar drejt kur ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik me ofertën e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët, duke siguruar përdorimin më racional të mjeteve publike.

Ndërsa për LOT-in 2 – Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në Shkollën Fillore "Lidhja e Pejës", oferta e OE **Bajram H. Gashi B.I.** është renditur si **oferta e tetë (8) me çmimin më të lartë**, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar operatorin ekonomik që ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “BAJRAM HA.GASHI B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **BAJRAM HA.GASHI B.I.**

Pretendimi nr.1

Pas analizimit të shkresave të lëndës, ankesës së parashtruar anë OSHP me nr.535/26, kërkesës për rishqyrtim dhe vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, kemi gjetur se OE ankues si në kërkesë për rishqyrtim ashtu edhe në ankesë të parashtruar në OSHP ka ngritur pretendime ankimore kundrejt tre OE-ve të renditur me çmim më të ulët se OE ankues.

OE ankues pretendon se të tre OE-të kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme dhe për secilin OE , duke filluar nga OE i rekomanduar për kontratë ka ngritur një mori të pretendimeve ankimore.

AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, ka potencuar se OE ankues për lot.1 në rastin konkret është i katërti i renditur me çmim andaj nuk mund të jetë fitues i kontratës.

AK po ashtu nuk është përgjigjur fare në pretendimet ankimore të OE ankues duke kthyer përgjigje se është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Në cilësi të ekspertit shqyrtues vlerësojmë se në rastin konkret AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së duke mos u përgjigjur në pretendimet ankimore.

Po ashtu vleftësojmë se nuk është i saktë pretendimi i AK-së se OE ankues nuk mund të jetë fitues me arsye se është i renditur i katërti me çmim, përderisa OE ankues ka ngritur pretendime ankimore për të tre OE-të që janë me çmim më të ulët se OE ankues.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe rekomandojmë që me rastin e rivlerësimit AK të jap përgjigje konkrete në pretendimet ankimore për secilin pretendim veq e veq duke kundër argumentuar pretendimet e OE ankues, në të kundërtën (në mungesë të kundër argumenteve) AK duhet të pranoj ankesën si të bazuar.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**BAJRAM HA.GASHI B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës se sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës se sportit ne shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës ne sallën e sportive te shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit te sallës se sportit ne shkollën fillore Lidhja e Pejës**” me numër të prokurimit: “**635-26-2916-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PEJES**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “BAJRAM HA.GASHI B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sportive të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **BAJRAM HA.GASHI B.I.**



Ilir Halili